ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr. i Prokurimit	**214-24-1540-1-2-1**
Nr i brendshëm	**214/24/009/121**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me Pajisje Policore për Gjeneratën e 59-të". Lot 1 dhe 2**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Sodex Group SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fehmi Agani Nr.36

(Adresa)

Prishtinë — ***10 000***

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044148184

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Luan Avdiu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

office@sodex-ks.com

(Adresa elektronike)

19.04.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K SODEX GROUP 55336 -1- PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë:28.02.2024 Hapja e ofertave: 19.03.2024 Njoftim mbi vendimin e AK-së: 02.04.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt. 05.04.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.12.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 56 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së.** **Neni 72 i LPP-së.** **Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 02.04.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për Lot 1 dhe 2 është rekomanduar për kontratë OE AR&BUS-Prishtinë, ndërsa për Lot 1 ne jemi shpallur si OE i pasuksesshëm, ndërsa për Lot 2 jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim: *"Për pjesën 2 OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka dorëzuar autorizim për prodhuesin Glok për artikullin numër 2 ku mostra e dorëzuar është e prodhuesit glok po ashtu edhe tek lista e përshkrimit të çmimeve figuron emri i prodhuesit glok".*

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë për Lot 1 dhe Lot 2, dhe pas analizës që i kemi bërë dokumentacionit të të njëjtit operator ekonomik kemi ardh në përfundim se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Për Lot 1 Furnizim me bateri rimbushëse.
Tek specifikimet teknike të detyrueshme është kërkuar që materiali "Body: Aircraft grade aluminum with non-slip rubberized comfort grip with anti-roll rubber ring" të jetë nga alumini.
Në lidhje me këtë kërkesë/specifikim, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar "Glass filled nylon polymer", i cili material është me i dobët se sa alumini dhe nuk është as për së afërmi sipas kërkesës tek specifikimet teknike, pra nuk është ekuivalent apo më i mirë. Duka u bazuar në këtë fakt kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar konform kësaj kërkese, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.
Tek pyetjet dhe përgjigjet sqaruese të dt.05.03.2024 është lejuar që të ofertohet me produkte që e tejkalojnë kualitetin e kërkuar, ndërsa nuk është lejuar që të ofertohet me produkte me kualitet më të dobët, prandaj në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me kualitet më të dobët dhe faktikisht është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu tek specifikimet teknike është kërkuar që drita të ketë Light Source C4 LED, ndërsa produkti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e posedon këtë veçori/karakteristik, prandaj rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikat e dosjes së tenderit.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 është i papërgjegjshëm dhe nuk ka mundur i njëjti të rekomandohet për kontratë.

Lot 2 – Furnizim me pajisje policore.
Tek produkti nr.2, është kërkuar "*Rechargeable at minimum 1000 times*", ndërsa kur analizohet katalogu i OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se askund në katalog ose në internet nuk figuron që bateria e brendshme është rechargeable at min. 1000 times, ashtu siç është specifikuar tek kërkesa e lartcekur.

Gjithashtu edhe Mbajtësi i magazine pouch, nuk është ekuivalent pasi që në kërkesë tek specifikimet teknike është kërkuar magazine pouch, që ngjitet direkt në rryp pa asnjë pjese shtese. Po ashtu mbajtësi i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është shumë me i gjerë se sa mbajtësi i kërkuar nga autoriteti kontraktues dhe nga ky fakt kuptohet që i njëjti OE është i papërgjegjshëm.
OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar produktin "magazine pouch" e cila nuk përbëhet prej një pjese dhe gjithashtu e njëjta përmban materiale të hekurit (bulon) gjë që e pengon gjatë lëvizjes së operatorit.

Dizajni i produktit të OE të rekomanduar për kontratë nuk është fare ekuivalent me kërkesën tek specifikimet teknike, pra në këtë rast nuk kemi të bëjmë me produkt ekuivalent ose me te mire siç është kërkuar në dosje të tenderit. Po ashtu as në dosje të tenderit e as me ndonjë sqarim nuk është lejuar që të ofertohet me produkte me kualitet më të dobët se sa është përcaktuar në dosje të tenderit.

Lot 1 dhe 2
OE i rekomanduar për kontratë ka klasifikuar sekret afarist ISO certifikatën 9001 dhe autorizimin e prodhuesit. Ne nuk e kemi të qartë se çfarë sekreti përmban kjo certifikatë, pasi që e njëjta nuk duhet të trajtohet si sekret afarist por përkundrazi tregon vlerë shtesë të një prodhuesi. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues që të verifikohen këto dokumente se a janë valide dhe sipas kërkesës, e po ashtu të verifikohet se kush është prodhuesi për produktin

Nr.1 për Lot 1 dhe produktin Nr.2 për Lot 2, a është Bayco apo Luxgend Elektronics Co dhe të verifikohet se a është lëshuar autorizimi nga prodhuesi dhe a është i njëjti i certifikuar me ISO 9001:2015.

Neve jemi eliminuar për mungesë të një autorizimi **për Lot 2**, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka shumë mangësi tek specifikimet teknike dhe është rekomanduar për kontratë, prandaj në këtë rast vërehen përdorim i standardeve të dyfishta nga ana e autoritetit kontraktues, në raport me kompaninë tonë. OE i rekomanduar për kontratë favorizohet hapur edhe pse nuk i plotëson kërkesat dhe specifikimet teknike të detyrueshme, ndërsa ne eliminohemi për mungesë të një autorizimi dhe ky veprim është në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së, pra kemi trajtim jo të barabartë, pasi që ka mundur edhe të kërkohen sqarime shtesë nga ne konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, duke e favorizuar të njëjtin edhe pse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.12.04.2024, mirëpo në asnjë mënyrë nuk janë argumentuar përgjigjet e AK-së në raport me pretendimet tona ankimore.
Në lidhje me pretendimin e parë ankimor për pjesën 1, AK-së është përgjigjur si në vijim:

- **Pretendimi se për pjesën 1 bateria ka ofruar Glass filled nylon polymer nuk qëndron pse ne katalogun e dorëzuar për bateri shkruan qarte se bateria është e nderuar si ne vijim "Constructed of 6061-T6 anodized aluminum with aggressive knurling for positive grip pra sipas katalogut dhe mostrës se dorëzuar është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe sqarimet ne fazën e tenderimit para hapjes se tenderëve , andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar.**

Nga kjo përgjigje nuk dëshmohet ajo që pretendon AK-së, dhe nuk dëshmohet e kundërta e pretendimit tonë ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar "Glass filled nylon polymer", i cili material është me i dobët se sa alumini dhe nuk është sipas kërkesës tek specifikimet teknike.

Në lidhje me driten **Light Source C4 LED**, AK-së është përgjigjur se ky pretendim nuk qëndron dhe se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dritën sipas kërkesës.

Edhe kjo përgjigje është abstrakte dhe e pa argumentuar por është vetëm pohim i AK-së se mostra është sipas kërkesës, prandaj nuk mund të merret paraysh kjo përgjigje pa ndonjë dëshmi kobnkrete.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor, se askund në katalog ose në internet nuk figuron që bateria e brendshme është rechargeable at min. 1000 times, ashtu siç është specifikuar tek kërkesa e lartcekur, AK-së është përgjigjur si më poshtë:

- **Pretendimi se artikulli numër 2 është kërkuar "Rechargeable at minimum 10 times" dhe mostra e dorëzuar nuk e përmbushë nuk qëndron pasi OE**

rekomanduar për kontratë i janë kërkuar sqarime pikërisht për ketë artikull dhe kemi konfirmimin e prodhuesi se bateri është Rechargeable at minimum 1000 times, andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar.

Përgjigja se kanë konfirmim nga prodhuesi për këtë artikull, pasi që i janë kërkuar sqarime për këtë artikull, tregon qartë për favorizim të OE të rekomanduar për kontratë, sepse për këto çështje nuk lejohet të kërkohen sqarime, pasi që secilit operator ekonomik apo prodhues kur i kërkohen sqarime, mund të pohon një gjë të tillë dhe mund të bëjnë ndryshime edhe në katalog, mostra apo edhe në prodhim, por që ato ndryshime pastaj janë substanciale.
Sqarimet të cilat i cek AK-së ne nuk i kemi pasur si dëshmi, mirëpo pavarësisht kësaj, me vetë faktin që AK-së e ka cekur se janë kërkuar sqarime, kuptohet që pretendimi jonë është i bazuar sepse bateria e brendshme nuk ka qenë rechargeable at min. 1000 times. Pra me këtë fakt dëshmohet papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor përkitazi se mbajtësi i magazine pouch, nuk është ekuivalent pasi që në kërkesë tek specifikimet teknike është kërkuar magazine pouch, që ngjitet direkt në rryp pa asnjë pjese shtese, AK-së është përgjigjur si më poshtë:.

Pretendimi se artikulli numër 3 tek Pjesa 2 nuk është ne kuadër te specifikave teknike nuk qëndron pasi artikulli numër 3 mostra e dorëzuar është ne përputhje me specifikat teknike ne specifikat teknike tipi është kërkuar Mag Pouch dhe mostra e ofruar është ne përputhje me specifikat teknike pretendimet se ka bulona si te metalit e qe munde te jen pengës janë supozime te pabazuar pasi nuk është kërkuar askund te ketë apo jo bulona ne specifika teknike, andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar.

Kjo përgjigje e AK-së, nuk përkon fare me realitetin e mostrës së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, prandaj autoriteti kontraktues me këtë përgjigje ka tentuar të shmanget nga realiteti dhe çështja kryesore, duke thënë se nuk janë kërkuar askund bulona. Ne, në pretendim nuk kemi thënë se janë kërkuar bulona, por kemi sqaruar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar produktin "magazine pouch" e cila nuk përbëhet prej një pjese dhe gjithashtu e njëjta përmban materiale të hekurit (bulon) gjë që e pengon gjatë lëvizjes së operatorit.
Po ashtu kemi sqaruar se mbajtësi i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është shumë me i gjerë se sa mbajtësi i kërkuar nga autoriteti kontraktues, ndërsa në lidhje me këtë pretendim nuk kemi marr asnjë përgjigje.

Në lidhje me deklarimin sekret afarist të Iso certifikatës dhe Autorizimit, nuk është dhënë asnjë përgjigje e arsyetuar por vetëm është thënë se janë klasifikuar si sekret afarist edhe pse pretendimi jonë ka qenë që të verifikohen këto dokumente se a janë valide dhe sipas kërkesës, mirëpo nuk është ndërmarr asnjë veprim për të verifikuar këto dokumente. Edhe pse këto dëshmi nuk mund të klasifikohen sekret afarist, autoriteti kontraktues i ka pranuar si të tilla, madje nuk ka shpreh fare interesim ti verifikojë këto dokumente.

Vendimi për refuzim i kërkesës për rishqyrtim është vendim subjektiv, i njëanshëm, joprofesional dhe i pa arsyetuar dhe i pa argumentuar, prandaj me këtë vendim po dëshmohet se autoriteti kontraktues po vazhdon veprimet kundërligjore dhe trajtimin jo të barabartë të operatorëve ekonomik ofertues, duke vazhduar diskriminimin e kompanisë tonë dhe favorizimin e OE të rekomanduar për kontratë në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht

nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues, sepse nuk janë trajtuar të gjithë operatorët ekonomik njëjtë por është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu paragrafi 6 i kësaj dispozite, pika (vi) shkruan qartë citojmë "*që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*". Ndërsa në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm dhe oferta e tij nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e OE **Sodex Group SH.P.K. për Lot 1 dhe 2**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës **për Lot 1**, si dhe lënda të kthehet në
RIVLERSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës **për Lot 2** dhe ky Lot anulohet në mungesë të ofertuesve të përgjegjshëm.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 10,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*